



Dana 26-10-2018

REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

Numri i lëndës: 2018:057968

Datë: 25.09.2018

Numri i dokumentit: 00130877

P.nr.2596/17

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ-Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Penal, si gjykatë e shkallës së parë penale, e përbërë nga gjyqtari individual Elmaz Zenuni, me zyr.ligjor Gazmend Bytyqi në çështjen penale kundër të pandehurit [REDACTED] nga fshati [REDACTED] Republika e Sërbisë, për shkak të veprës penale rrezikimi i trafikut publik nga neni 378 par. 6 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Ferizaj PP/II.nr1448-4/17 të dt.18.10.2017, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar gjyqësor publik me datën 25.09.2018, në praninë e përfaqësuesit të akuzës - prokurorit të shtetit Valdet Avdiu, të pandehurit dhe përkthyesit zyrtar të gjykatës [REDACTED], të njejtën ditë morri dhe publikisht shpalli këtë:

AKT GJYKIM

I pandehuri, [REDACTED] nga fshati [REDACTED] Republika e Sërbisë, i lindur më [REDACTED] në të njejtin vend, nga i ati [REDACTED] dhe e ëma [REDACTED] e gjinisë [REDACTED] i martuar baba i 3 (tre) fëmijëve, ka të kryer shkollën fillore, pensionist, i gjendjes së mesme ekonomike, boshnjak, shtetas i Republikës së Serbisë.

## Ë SH T Ë F A J T O R

Sepse me datë:02.08.2017 rreth orës 10:50 në rrugën magjistrale Prishtinë-Ferizaj, përballë autosallonit "Nesi" në fshatin Prelez Komuna Ferizaj, duke e drejtuar automjetin e markës "Volsvagen Tiguan" me ngjyrë hiri, me targa të regjistrimit [REDACTED], në kundërshtim me dispozitat e nenit 41.1 të LSKRR nga pakujdesia ka rrezikuar trafikun publik, duke vënë në rrezik jetën e njerëzve dhe pasurin e tyre, hyn në tejkalim të kolonës dhe me pjesën e parë të automjetit e godet një automjet i cili ishte duke lëvizur Ferizaj-Prishtin, në këtë rast përveç dëmeve materiale lëndime të lehta trupore kanë pësuar [REDACTED], [REDACTED] dhe [REDACTED] të përshkuara si në ekspertizën e ekspertit të mjekësisë ligjore të dt.10.10.2017 e të cilat lëndime rezultojnë me pasoja të përkohshme të shëndetit,-

me këte ka kryer vepren penale rrezikim i trafikut publik nga neni 378 par. 6 të KPRK-së.

Andaj, në bazë të dispozitës ligjore të sipërtheksuar, si dhe dispozitave ligjore nga neni 3,7,17, 23, 41, 43, 45, 46 par.3,47 dhe 73 të KPRK-së, si dhe nenit 365 të KPPRK-së, të pandehurin e

## G J Y K O N

**Me Denim me gjobë në lartësi prej 300 euro** (me shkronja: treqind euro) të cilën gjobë detyrohet që ta paguaj në afat prej 30 ditëve nga dita kur aktgjykimi të merr formën e prerë.

Nëse dënimi me gjobë nuk mund të ekzekutohet as në mënyra tjera të parapara në nenin 46 par. 4 të KPK-së, në të kundërtën do ti zavendësohet në denim burgimi, ashtu që për çdo 20 € i pandehuri do të vuaj 1 (një) ditë burgu.

Në bazë të nenit 450 dhe 451 të KPPK-së obligohet i pandehuri Ibrahim Bishevac që në emër të shpenzimeve të procedurës penale të paguaj shumën prej 90.88 €, si dhe paushallin gjyqësor në shumë prej 20 € në afat prej 15 ditëve nga dita kur aktgjykimi të merr formën e prerë nën kërcënimin e përmbarrimit me dhunë.

Konform nenit 39 par.3.1 të Ligjit për Kompensimin e Viktimave të Krimit –Ligji nr.05/L-036, Obligohet i akuzuari që në emër të Taksës për Kompensimin e Viktimave të Krimit të paguaj shumën prej 30 eurove, në afat prej 15 ditëve, nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm.

Të dëmtuarit: 1. [REDAKTUAR] nga [REDAKTUAR] me vendbanim në Prishtinë Sheshi [REDAKTUAR], 2. [REDAKTUAR] nga Prishtina me vendbanim në rrugën [REDAKTUAR] dhe 3. [REDAKTUAR] nga [REDAKTUAR] për realizimin e kërkesës pasuroro-juridike udhëzohen në kontest civil.

### A r s y e t i m i

Prokuroria Themelore në Ferizaj me aktakuzën e saj PP/II.nr1448-4/17 të dt.18.10.2017, ka ngarkuar të pandehurin [REDAKTUAR] nga fshati [REDAKTUAR] Republika e Sërbisë, për shkak të veprës penale rrezikimi i trafikut publik nga neni 378 par. 6 të KPRK-së.

Gjykata duke vepruar në këtë çështje penale mbajti shqyrtimin fillestar më datën 25.09.2018 në të cilën përfaqësuesi i akuzës - prokurori i shtetit Valdet Avdiu, lexoj aktin akuzues, ku deri në fjalën përfundimtare ka deklaruar se qëndron në tërësi pranë akuzës dhe kualifikimit juridik të veprës penale, duke i propozuar gjykatës që i njehti të shpallet fajtor dhe ti shqiptohet dënim i paraparë me ligj. Gjyqtari pasi që u bind se i pandehuri e ka kuptuar aktakuzën konform nenit 246 të KPPRK-së, të pandehurit i ofroj mundësinë të pranoj fajësinë ose të deklarohet i pafajshëm.

I akuzuari [REDAKTUAR] në shqyrtim fillestar gjyqësor të dates 25.09.2018 ka deklaruar se e pranon fajësinë për veprën penale e cila i vihet në barrë.

Konform nenit 246 të KPPRK-së të pandehurit pasi që i janë dhënë udhëzimet nga ana e gjyqtarit gjatë shqyrtimit fillestar përkitazi me pranimin e fajësisë, i akuzuari e ka pranuar fajësinë sipas aktakuzës për veprën penale që e ngarkon prokurori i shtetit.

Në vlerësimin e pranimit të fajësisë së të pandehurit gjyqtari gjykues konform nenit 248 par.2 të KPPRK-së ka kërkuar edhe mendimin e prokurorit të shtetit përkitazi me pranimin e



fajsisë nga ana e të akuzuarit, ashtu që prokurori i shtetit është pajtuar me pranimin e fajsisë nga ana e të akuzuarit të cilët kanë deklaruar se mundë të shkohet me shqiptimin e dënimit.

Gjyqtari gjykues ka vlerësuar se kërkesat nga neni 248 paragrafi 1 i KPPRK-së janë përmbushur, pasi që:

- I pandehuri ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajsisë,
- Pranimi është bërë vullnetarisht,
- Pranimi mbështetet në prova dhe fakte të çështjes penale që përmban
- aktakuza dhe materialet e prezentuara nga ana e prokurorit të shtetit me aktakuzë dhe atë: Ekspertiza e ekspertit të Komunikacionit e dt.07.08.2017, Ekspertiza mjeko ligjore e dt.10.10.2017, si dhe fotografitë e vendit të ngjarjes
- akuza nuk përmban asnjë shkelje ligjore ose gabime faktike, njashtu i akuzuari është udhëzuar nga ana e Gjyqtarit gjykues edhe konform neni 383 par.2 të KPPRK-së, përkitazi me të drejtën e ankesës vetëm për sanksionin penal, por jo edhe për shkak të gjendjes faktike, si dhe
- Konform neni 257 të KPPRK-së, aktakuza nuk ka prova të pa pranuesheme.

Të dëmtuarit: 1. [REDAKTUAR] nga Lipjani me vendbanim në Prishtinë Sheshi [REDAKTUAR], 2. [REDAKTUAR] nga Prishtina me vendbanim në rrugën [REDAKTUAR] dhe 3. [REDAKTUAR] nga [REDAKTUAR] nuk kanë prezentuar në shqyrtim fillestar, pasi që konform neni 245 par 7 të KPPRK-së, nuk kërkohet prania e tyre në shqyrtim fillestar gjyqësor.

Meqenëse i pandehuri ka pranuar fajësinë e cila është në përputhje me kriteret e përcaktuara me nenin 248 par.1 të KPPRK-së, kryetari i trupit gjykues, konform neni 248 par.4 të KPPRK-së, është bindur se mjaftueshm janë vërtetuar faktet, nuk ka prova të pa pranueshme të përcaktuara sipas neni 257 të KPPRK-së ka vazhduar me shqiptimin e dënimit ( nëse i pandehuri në shqyrtimin fillestar pranon fajësinë dhe Kryetari i trupit gjykues vlerëson se pranimi i fajit është bërë në pajtim me ligjin mund të vazhdoj procesin me shqiptimin e dënimit pa plotësuar trupin gjykues dhe pa e mbajtur fare shqyrtimin gjyqësorë dhe pa paraqitur fare fjalë përfundimtare, lidhur me këtë shih Mendimin Juridik të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës të evidentuar si GJA.nr.207/13 të dt.19.03.2013).

Vlersuar në aspektin juridik formësohen të gjitha tiparet subjektive dhe objektive të veprës penale rrezikimi i trafikut publik nga neni 378 par.6 lidhur me par.1 të KPRK-së.

Me rastin e caktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit, gjykata pati parasysh të gjitha rrethanat në kuptim të nenit 73 të KPRK-së, si shkallën epërgjegjësisë, motivet e kryerjes së veprës, rrethanat e kryerjes si dhe ato personale të kryesit, e njashtu edhe pranimin e fajsisë, të cilat ndikojnë në përcaktimin e llojit dhe lartësisë së dënimit.

Gjykata si rrethana veçanërisht lehtësuese në kuptim të nenit 75 të KPRK-së, ku mori parasysh pranimin e fajsisë nga ana e të pandehurit, pendimin e thellë për kryerjen e kësaj vepre penale, nuk është i evidentuar më parë si kryes i veprave penale, është i moshës relativisht të vjeter, i martuar dhe baba i 3 fëmijëve, jeton prej pensionit, kurse rrethana veçanërisht rënduese gjykata nuk gjeti dhe mbi bazën e këtyre rrethanave vleroi shkallën e rrezikshmerisë dhe peshën e kësaj vepre penale. Gjykata, pasi që ka marrur mendimin e prokurorit të shtetit, të dëmtuarit konform nenit 75 par.1 nënpar.1.3 të KPRK-së bëri edhe zbutjen e dënimit konform nenit 76 par.1 nënpar.1.5 të KPRK-së dhe ate nën minimumin ligjor të kufirit minimal të dënimit, dhe gjykata bëri zbutjen e dënimit nënë kufijtë e paraparë të minimumit ligjor ku të pandehurit konform nenit 46 par.3 i shqiptoi në dënim me gjobë, gjykata e ka caktuar konform nenit 46 par.4 të KPRK-së, duke qenë e bindur se me dënimin e shqiptuar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi arrihet qëllimi ndëshkimor si preventivë speciale dhe gjenerale për të përmbajtur të pandehurin, por edhe personat e tjerë në kryerjen e veprave penale, dhe kështu gjykata mendon se me këtë dënim do të arrihet qëllimi ndëshkimor i paraparë me nenin 41 të KPRK-së.

Në bazë të nen. 450 dhe 451 të KPRK-së gjykata të pandehurin e obligoi që të paguaj shpenzimet e procedurës penale për 2 ekspertiza në shumë prej 90.88 €, si dhe paushallin gjyqësor në shumë prej 20 €, në afat prej 15 dite pasi që aktgjykimi të merr formën e prerë nën kërcënim të përmbarimit me dhunë.

Konform nenit 39 par.3.1 të Ligjit për Kompensimin e Viktimave të Krimit –Ligji nr.05/L-036, Obligohet i akuzuari që në emër të Taksës për Kompensimin e Viktimave të Krimit të paguaj shumën prej 30 eurove, në afat prej 15 ditëve, nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm.

Në bazë të nenit 458,459 dhe 460 të KPPRK-së gjykata të dëmtuarit: 1. [REDAKTUAR]  
[REDAKTUAR] nga Lipjani me vendbanim në Prishtinë Sheshi [REDAKTUAR], 2. [REDAKTUAR] nga  
[REDAKTUAR] me vendbanim në rrugën "[REDAKTUAR]" dhe 3. [REDAKTUAR] nga  
[REDAKTUAR], për realizimin e kërkesës pasuroro-juridike udhëzohen në kontest  
civil, për shkak të asaj se nuk është specifikuar lloji dhe lartësia e dëmit.

Nga të gjitha të thekësuarat më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ**  
**P.nr.2596/17 datë 25.09.2018**

Zyr. ligjor,  
**Gazmend Bytyqi**

**Gjyqtari,**  
**Elmaz Zenuni**



**KËSHILLA JURIDIKE:**

Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa  
Gjykatës së Apelit në Prishtinë, në afat prej 15 ditësh,  
nga dita e pranimit të aktgjykimit nëpërmjet kësaj gjykate.  
Kurse, i dëmtuari mund të paraqet ankesë vetëm sa i përket  
Vendimit për sanksionin penal.

Nga një kopje e aktgjykimit të iu dërgohet të dëmtuarve / 1. [REDAKTUAR] nga Lipjani me vendbanim në Prishtinë Sheshi [REDAKTUAR]  
[REDAKTUAR], 2. [REDAKTUAR] nga Prishtina me vendbanim në rrugën "[REDAKTUAR]" dhe 3. [REDAKTUAR] nga [REDAKTUAR]